



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 583/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovë (LDK).

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LDK paraqitur kundër KQZ-se, në të cilën pretendohet se “në të gjitha qendrat e vendvotimit, po ashtu edhe nga dëshmitë e dhëna nga Nysret Bytyqi, kryetar i KKZ-se dhe Nazmi Mucaj, anëtar i KKZ-se Prizren, është vërtetuar se që nga hapja e vendvotimeve nga ora 07:00 e deri në orën 13:00 në mbi gjysmën e qendrave të vendvotimit në komunën e Prizrenit, është votuar pa llampa detektuese të gishtërinjve, pasi ato kanë qene jofunksionale. Pjesa tjetër e tyre ka funksionuar shumë dobët. Pas dhënies së vërejtjeve nga ana e LDK-se, KKZ-ja ka reaguuar pas orës 13:00, duke sjelle 100 llampa të tjera, të cilat me pas janë shpërndarë vetëm në vendvotimet brenda qytetit, kurse neper qendrat e votimit në fshatra nuk janë dërguar llampa të tjera, që i bie se votimi ka vazhduar me llampa jofunksionale-qe nga mëngjesi e deri në mbyllje të vendvotimeve”. Sipas parashtruesit të ankesës këto janë shkelje të rënda të procesit zgjedhor, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet përfundimtare të votimit- LDK në Prizren, prandaj kërkon rivotim për të gjitha qendrat e votimit në komunën e Prizrenit”.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve ne pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 "Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie".

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e LDK-se paraqitur përkundrejt KQZ-se, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjate procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe ne pajtim të dispozitave ligjore të cekura me lartë si dhe ne pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 583/2010 më datën 15.12.2010.

